

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
MINISTRIA E INDUSTRIE, NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË  
MINISTARSTVO INDUSTRIJE, PREDUZETNIŠTVA I TRGOVINE  
MINISTRY OF INDUSTRY, ENTREPRENEURSHIP AND TRADE

Nr./Br./No. 7273/19 Nr./faq./Br./str./No.pg  
Data/Datum/Date 08/12/2023  
PRISHTINË



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:211949  
Datë: 22.11.2023  
Numri i dokumentit: 04958701

Ka. nr. 338/2023

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në Kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryetar i Kolegjit, Skender Çoçaj dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarës ligjore Rrezarta Bala, në çështjen kundërvajtëse ndaj të pandehurit Subjekti ekonomik - Person juridik “Petroll company” SH.P.K, me numër biznesi 810527195- drejtor Shkelzen Jusaj me seli në Prizren , në rrugën “Tirana” – tani në rrugën “ Isail Kryeziu “ p.n., për kundërvajtje nga neni 4 të Ligjit Nr. 2004/05 për Tregti me Naftë dhe Derivate të Naftës në Kosovë, e sanksionuar sipas nenit 19 par.2.1 të Ligjit Nr. 08/L-18 për Tregti me produktet të naftës dhe karburanteve të ripërtrishme, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga Ushtruesi i Kërkesës – MINT-së, - Inspektorati i Tregut, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K.nr.175-4/21, të datës 13.07.2023, në bazë të nenit 55 par. 3 dhe nenit 78, konform të nenit 143 par. 1 dhe par. 2, të Ligjit për Kundërvajtje, Nr. 05/L-087, më datë 22.11.2023, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**APROVOHET** si pjesërisht e bazuar ankesa e paraqitur nga Ushtruesi i Kërkesës – MINT-së, - Inspektorati i Tregut, dhe **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K.nr.175-4/21, të datës 13.07.2023, konform nenit 5 të LK-së, **sa i përket cilësimit juridik**, ashtu që vepra kundërvajtëse për të cilën pandehurit Subjekti ekonomik - Person juridik “Petroll company” SH.P.K, me numër biznesi 810527195- drejtor Shkelzen Jusaj me seli në Prizren , në rrugën “Tirana” – tani në rrugën “ Isail Kryeziu “ p.n., është shpall përgjegjëse cilësohet si vepër kundërvajtëse nga neni 6 par. 2 pika 2.7 sanksionuar sipas nenit 19 par. 1 dhe par. 2 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregti me Produktet të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtrishme, **si dhe sa i përket gjobë së shqiptuar** ashtu që i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej **7.000(shtatë mijë)€**, të cilën ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e caktuar e njëjta do të arkëtohet me dhunë sipas Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

**Në pjesën tjetër aktgjykimi mbetet i njëjtë.**

Nga një kopje të këtij aktgjykimi duhet dorëzuar palëve.

## Arsyetim

Gjykata Themelore në Prizren- Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, duke vendosur sipas Kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse të ushtruar nga ana e MINT-së - Inspektorati i Tregut, në Prizren, me numër të Ref. 19/21 të datës 22.01.2021, e me numër të Protokollit 6692, me aktgjykim K.nr.175-4/21, të datës 13.07.2023, të pandehurën Subjekti ekonomik - Person juridik "Petroll company" SH.P.K, me numër biznesi 810527195- drejtor Shkelzen Jusaj me seli në Prizren , në rrugën "Tirana" – tani në rrugën " Isail Kryeziu " p.n., e ka shpall përgjegjëse sepse:

-me datë 04.08.2021-15.09.2021, e në vazhdim, gjerë me dt.07.12.2022, në orën e papërcaktuar, në Prizren, "Petrol Company", Sh.p.k, njësia e cila gjendet në rrugën, "Tirana", tash rruga, "Ismail Kryeziu" pa nr. gjatë inspektimit (kontrollimit) të kryer nga inspektorëve të tregut të MINT-së, në Subjektin Ekonomik, "Petrol Company", Sh.p.k, me Numër të Biznesit, 810527195 (shitje me pakicë e NDN-së) është konstatuar se ka ushtruar veprimtarin e shitjes me pakicë e NDN-së, - dizelit dhe benzinës pa licencë valide të lëshuar nga organi kompetentë. Me çka kanë kryer kundërvajtje nga neni, 4 të Ligjit për Tregti me Naftë dhe Derivate të Naftës, në Kosovë, që ndëshkohet sipas nenit 19 par. 2.1 Ligjit NR. 08/L-18, për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtëritshme, andaj gjykata në bazë të neneve, 8, 9,13, 27, 28 par. 1, 31, 35, 48 par. 2, 55, 59, 76, 86, 92 par. 5, 124, 127, 130, të Ligjit për Kundërvajtje, Nr. 05/L-087, nga neni 4 të Ligjit për Tregti me Naftë dhe Derivate të Naftës, në Kosovë, që ndëshkohet sipas nenit 19 par. 2.1 Ligjit NR. 08/L-18, për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtëritshme e ka denuar e gjobë në shumë prej, 500 (pesëqindtë) €. E pandehura obligohet që gjobën e shqiptuar dhe shumën prej 5 Euro, në emër të shpenzimeve të procedurës të paguajnë në afat prej 15 ditësh, nga plotfuqishmëria e Aktgjykimit, apo varësisht nga gjendja ekonomike, mundë të e paguaj edhe me këste, në të kundërtën gjoba e shqiptuar dhe shpenzimet e cekura më lartë do të arkëtohen me dhunë në bazë të dispozitave mbi arkëtimin me dhunë të tatimit, në vështirim të nenit 163 par. 4, të Ligjit për Kundërvajtje. E pandehurit poashtu, obligohen që pas kryerjes së pagesës ta njoftojnë këtë gjykatë.

Kundër këtij aktgjykimi ka paraqitur ankesë Ushtruesi i Kërkesës MINT – Inspektorati i Tregut, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe aplikimit të gabuar të procedurës kundërvajtëse.

Në arsyetim të ankesës veç tjerash thekson se: gjykata gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë ka vlerësuar gjendjen faktike reale, për shkak se inspektorët e MINT me datë prej 14.08.2021 – 15.09.2021 e në vazhdim deri më datë 07.12.2022 kanë inspektuar operatorin ekonomik "Petrol Company" – SH.P.K., njësia në lagjen Arbana në Prizren, me ç rast në procesverbalin me numër 19/0000552 është konstatuar kjo gjendje faktike, pala prezente në mungesë të pronarit nuk ka prezantuar licencën valide për ushtrimin e veprimtarisë të NDN-së (leje e shitjes me pakicë të dizelit, benzinës dhe bio karburanteve) dhe as licencë për shitje me pakicë të KLN-së (leje e shitjes me pakicë të gazit të lëngëzuar). Gjithashtu konsiderojmë që gjykata gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale sepse subjekti i lartë cekur ka bërë shkelje kundërvajtëse nga neni 4 par.4.1 me të cilën ceket se asnjë person nuk mund të merret me import ose shitje të derivateve të naftës, brenda kapaciteteve të shitjes me shumicë dhe pakicë, për qëllime afariste, pa licencë aktuale të lëshuar nga zyra e licencimit – MTI. Për veprën kundërvajtëse të lartë cekur është përcaktuar dispozita ndëshkuese e lartë cekur sipas nenit 14.1 të Ligjit me numër 2004/05, për Tregti me Naftë dhe Derivate të Naftës, për të cilën sanksion parashihet sanksion prej 10.000 € deri në 30.000 €, ndërsa me ligji 08/L-018 për Tregti me produkte të Naftës dhe karburanteve të

ripërtrishme është përcaktuar se kush pa leje shet me pakicë produkte të naftës ose karburante të ripërtrishme dënohet me gjobë prej 5.000 deri në 15.000 si person juridik. I propozon Gjykatës se Apelit - Divizioni i Kundërvajtës, që ankesën ta aprovoj si të bazuar, aktgjykimin e goditur ta Anuloj dhe lëndën ta kthej në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesën e parashtruesit të kërkesës për iniciimin e procedurës kundërvajtëse ka ushtruar i autorizuari i të pandehurit “Petrol Company” me propozim që ankesa të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Kolegji i kësaj Gjykate, duke i vlerësuar thëniet në ankesën e paraqitur, aktgjykimin e goditur, në bazë të deklaratës së pronarit Shkelzen Jusaj, si Përfaqësues i të pandehurës të dhënë pranë Gjykatës së shkallës së parë, si dhe nga provat e bashkangjitura në shkresa të lëndës, e duke i analizuar secilën provë, veç e veç dhe duke i ndërlidhur të gjitha së bashku, ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurës formohen të gjitha elementet qenësore të veprës kundërvajtëse, të përshkruar si në dispozitiv të Aktgjykimit dhe se i pandehuri në aspektin kundërvajtës - juridik, është përgjegjës, për çka gjykata të njëjtin e shpalli përgjegjës dhe i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga provat e lartë cekura me padysim se e ka vërtetuar gjendjen faktike se i pandehuri ka kryer veprën kundërvajtëse nga neni neni 4 të Ligjit Nr. 2004/05 për Tregti me Naftë dhe Derivate të Naftës në Kosovë, e sanksionuar sipas nenit 19 par.2.1 të Ligjit Nr. 08/L-18 për Tregti me produktet të naftës dhe karburanteve të ripërtrishme, të cilën gjykata bazuar në nenin 5 të LK-së, e ka ri – kualifikuar, po ashtu te përkufizimet në Ligjin Nr. 08/L-018 për Tregti me Produktet të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtritshme, në nenin 3 par. 1 pika 1.6. thotë citim: “**karburantet e naftës** - karburantet e përfituara nga nafta, siç janë dizeli, benzina, karburanti në fushën e aviacionit, **gazi i lëngëzuar i naftës**, (GLN), që do të thotë se GLN-së, është Karburant i naftës, andaj për këtë kundërvajtje mban përgjegjësi kundërvajtëse.

Kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ushtruesit të Kërkesës - ankesës janë të bazuara, në ç rast mori parasysh peshën dhe rrezikshmërinë e veprës së kryer, andaj gjoba e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë me aplikim të nenit 35 të LK-së, në shumë prej 500 €, nuk është adekuate me shkallën e përgjegjësisë, peshën, rrezikshmërinë, pasojat në ç rast si pasojë vendimi mbi dënimin ka mbetur i pa bazuar në prova bindëse të cilat do të mund të arsyetonin shqiptimin e dënimit me gjobë në shumë prej 500 €.

Si rrjedhojë e të cekurave më lartë Kolegji e NDRYSHOJ aktgjykimin e goditur, sa i përket cilësimit juridik duke aplikuar Ligjin në fuqi, i cili është më i favorshëm për të pandehurën si dhe sa i përket gjobës së shqiptuar, ashtu që të pandehurit **subjektit ekonomik** - Person juridik “Petroll company” SH.P.K, me numër biznesi 810527195- drejtor Shkelzen Jusaj me seli në Prizren , në rrugën “Tirana” – tani në rrugën “ Isail Kryeziu “ p.n., i shqiptoi gjobën në shumë prej 7.000 (shtatë mijë)€, duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë se të pandehurit, peshën, rrezikshmërinë, pasojat e veprës se kryer, duke konsideruar se me gjobën e shqiptuar tani do të arrihet qëllimi i ndëshkimit ashtu që i pandehura në të ardhmen të mos kryej vepra kundërvajtëse të njëjta apo të ngjashme.

Në vështrim të nenit 143 par. 1 dhe par. 3 të LK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi nuk është e lejuar ankesa.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**Ka. nr. 338/2023, me datë 22.11.2023**

**ZYRTARJLIGJORE**  
**Rrezarta Bala**

**KRYETARI I KOLEGJIT,**  
**Ferit Osmani**

